

VENDIM
Nr. 400, datë 27.7.2000

PËR MIRATIMIN E PRIVATIZIMIT TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË
ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË

(Ndryshuar me VKM nr. 494, datë 19.9.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të nenit 4, shkronja “ç”, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të vendimit nr. 408, datë 31.8.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjeve shtetërore” dhe të vendimit nr. 433, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin me tender të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë”, me ndryshime përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e privatizimit të ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë, dhe shpalljen fitues të saj të “R.M.C Group p.o.c.&E.C.F.S.H.A. “Konsorcium”, si ofertë e vetme.
 2. Objekt i kontratës së shitjes së ndërmarrjes së prodhimit të çimentos, Fushë-Krujë, të jetë edhe shitja e sipërfaqes së truallit të saj.
 3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Privatizimit për zbatimin e këtij vendimi.
 4. *Nënshtetimi i kontratës së shitjes së ndërmarrjes së prodhimit të çimentos Fushë-Krujë do të kryhet nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit.*
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta